

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI EKONOMIK



PUNIM DIPLOME

Besart Thaçi

Mitrovicë, 2022

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



PUNIM DIPLOME

Tema: Vështrimi analitik i bruto prodhimit vendor dhe ndikimi në ekonomi

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Qazim Tmava

Kandidati:

Besart Thaçi

Mitrovicë, 2022

PUBLIC UNIVERSITY OF MITROVICA“ISA BOLETINI”
FACULTY OF ECONOMICS



BACHELOR THESIS

Tema: The analytical overview of gross domestic product and impact on the economy

Mentor :

Prof.Asoc.Dr. Qazim Tmava

The candidate :

Besart Thaçi

Mitrovicë, 2022

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



PUNIM DIPLOME

Lënda:	Financë publike
Titulli i punimit:	Vështrimi analitik i bruto prodhimit vendor dhe ndikimi në ekonomi
Emri dhe mbiemri:	Besart Thaçi
Statusi i studentit:	I rregullt
Numri i amzës:	1705011006
Niveli i studimeve:	Bachelor
Departamenti:	Banka, Financa dhe Kontabilitet
Programi i studimit:	Banka, Financa dhe Kontabilitet
Mentori i punimit:	Prof.Asoc.Dr. Qazim Tmava

Aprovuar prej komisionit:

1. _____ Kryetar
2. _____ Anëtar
3. _____ Mentor

Data e aprovimit: _____

Falënderim,

Këtë punim diplome e kam punuar në kuadër të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Mitrovicë, departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitet.

Falënderim i veçantë në rend të parë i takon mentorit të punimit të diplomës të nderuarit Prof.Asoc.Dr. Qazim Tmava për ndihmën e pakompromis, udhëzimet shumë të dobishme në dobi të zhvillimit dhe përfundimit me sukses të temës së diplomes.

Po ashtu falënderim i veçantë i takon edhe familjes për mbështetje morale dhe financiare.

Faleminderit të gjithëve.

Përmbatja

1.Hyrje	9
1.1.Qëllimi i punimit	11
1.2.Metodologjia e punës	12
2.Bruto prodhimi i brendshëm	12
2.1 Përlllogaritja e Prodhimit të brendshëm Bruto	13
2.2.Prodhimi i brendshëm bruto nominal dhe real	14
2.3 Dallimi midis “rritjes reale të PBB” dhe “rritjes nominal të PBB”	15
2.4.Produkti i brendshëm Bruto për frymë (kokë banori)	16
3.Efektet ekonomike të Prodhimit të brendshëm Bruto	16
4. Prodhimi i brendshëm bruto dhe mirëqenia ekonomike	17
5. Rritja e Prodhimi të brendshëm të Kosovës 2008-2017	17
5.1 Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike	19
5.1 Trendi i shpenzimeve qeveritare gjatë periudhës 2008-2017	20
6. Krahasimi mes Produktit të brendshëm Bruto dhe Produktit kombëtar Bruto të Kosovës	21
7. Ndikimi i pandemisë së koronavirusit në ekonominë globale	23
7.1. Ndikimi në tregjet globale të aksioneve	23
7.2.Industritë e prekura	24
7.3.Mbështetja e qeverisë	24
7.4.Kthimi në normalitet	25
7.5. Aksionet globale në fluks	28
Përfundimet	29
Literatura	30

Lista e figurave:

Figura 1. Bruto Prodhimi i Brendshëm i Kosovës me çmim aktual dhe faktorët.

Figura 2. Shpenzimet qeveritare dhe Prodhimi i brendshëm bruto.

Figura 3. Shpenzimet qeveritare, GDP-ja dhe konsumi

Figura 4. Prodhimi i brendshëm bruto nominal dhe real për kokë banori në rajon.

Figura 5. Krahasimi i PBB-së së Kosovës me vendet e rajonit.

Figura 6. Ndikimi i pandemisë Covid-19 në papunësi.

Figura 7. Recesioni i Prodhimit të brendshëm bruto nga Covid-19.

Figura 8. Impakti i covid-19 në tregje financiare.

Abstrakti

Për matjen, analizimin dhe vlerësimin e ekonomisë së një vendi duhet të mbledhen shumë të dhëna numerike që ka metoda të ndryshme për grumbullimin, selektimin dhe finalizimin e tyre.

Vlerësimi i kushteve ekonomike në kohë reale është sfiduese, pjesërisht për shkak se të dhënat ekonomike janë shumë të vështira për t'u matur dhe i nënshtrohen rishikimit të mëvonshëm kur të bëhet më shumë informacion. Ky punim jep njohuri të përgjithshme mbi bruto prodhimin e brendshëm (PBB). Ky punim heton efektet e GDP-së në ekonomi. Gjithashtu shqyrton mundësinë e përshtatjes së vlerësimeve në kohë reale të Prodhimit të brendshëm Bruto për modelet e dukshme në rishikime, duke parashikuar rishikimet e ardhshme dhe llogaritjen e intervaleve të besimit rreth të dhënave historike. Pasiguria rreth vlerësimeve të PBB-së në kohë reale thekson rëndësinë e monitorimit të një game të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të kushteve aktuale ekonomike.

Fjalë kyçe: Bruto Prodhimi Vendor, metodat e përlllogaritjes, Kosovë.

Abstract

To measure, analyze and evaluate the economy of a country must be collected a lot of numerical data that has different methods for their collection, selection and finalization.

Assessing economic conditions in real time is challenging, in part because economic data are very difficult to measure and are subject to subsequent revision when more information becomes available.

This paper provides general knowledge on gross domestic product (PBB). This paper investigates the effects of GDP on the economy.

It also examines the possibility of adapting real-time estimates of Gross Domestic Product to visible patterns in revisions, predicting future revisions, and calculating confidence intervals around historical data.

Uncertainty about real-time GDP estimates underscores the importance of monitoring a wide range of information when estimating current economic conditions.

Key words: Gross Domestic Products, Calculation Methods, Kosovo.

1.Hyrje

Fuqia e çdo shteti tregohet përmes fuqisë ekonomike që ato mbizotërojnë, si tregues kryesor i fuqisë dhe performancës ekonomike të një vendi është bruto prodhimi i brendshëm.

Bruto produkti i brendshëm është një ndër faktorët thënë ndryshe indikatorët kryesor të llogarive kombëtare. Ai përfaqëson vlerën totale në para të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente. Matja e Produktit të brendshëm Bruto është një proces i komplikuar, por në thelb vlerësimi i tij mund të bëhet me tri metoda:

- ✚ Metoda e Prodhimit
- ✚ Metoda e Shpenzimit
- ✚ Metoda e të Ardhurave.

1. Metoda e Prodhimit

Prodhimi i brendshëm Bruto është shuma e vlerave të shtuara bruto të prodhuara sipas degëve të ndryshme të ekonomisë duke shtuar taksat e tatimet dhe duke zbritur subvencionet mbi produktet.

2. Metoda e Shpenzimeve

Bazuar në këtë metodë Bruto Produkti i Brendshëm është shuma totale e përdorimit final të mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha njësitë rezidente institucionale + eksportet – importet e mallrave dhe shërbimeve.

3. Metoda e të ardhurave

-Bruto prodhimi i brendshëm përbën shumën e përgjithshme të përdorimeve në llogarinë e krijimit të të ardhurave në tërësi të ekonomisë si pagat e punonjësve, taksat për prodhim dhe import pa përfshirë në to ndihmat dhe të ardhurat e përziera (mikse) të ekonomisë në tërësi.

-Kur flasim për Prodhimin e brendshëm Bruto të një vendi është e rëndësishme të kuptojmë jo vetëm atë që është përfshirë në PBB, por edhe atë që nuk përfshihet në PBB. PBB qëndron për produktin e brendshëm bruto dhe përfaqëson prodhimin total të një kombi brenda kufijve të tij të brendshëm.

Ne e dimë nga formula e Prodhimit të brendshëm Bruto që produkti i brendshëm bruto = konsumi + investimi + blerjet qeveritare + (eksportet - importet). Megjithatë, ka disa transaksione që ndodhin çdo ditë që nuk llogariten në Produktin e brendshëm Bruto.

Në thelb, në mënyrë që diçka të përfshihet në Prodhimin e brendshëm Bruto tonë, ajo duhet të jetë diçka që prodhohet aktualisht. Duhet të jetë diçka që nuk përdoret për të prodhuar diçka tjetër. Ajo duhet të prodhohet këtu dhe jo diku tjetër, dhe gjithashtu duhet të jetë e ligjshme.

Çfarë nuk përfshihet në Produktin e brendshëm Bruto?

Pra, këtu është një listë e gjërave që nuk përfshihen:

- Shitjet e mallrave të prodhuara jashtë kufijve tanë vendas
- Shitjet e mallrave të përdorura
- Shitjet ilegale të mallrave dhe shërbimeve (që ne e quajmë tregu i zi)
- Pagesat e transferimit të bëra nga qeveria
- Mallrat e ndërmjetme që përdoren për të prodhuar mallra të tjera përfundimtare¹

Vetëm produktet dhe shërbimet e prodhuara brenda vendit përfshihen brenda PBB-së. Kjo do të thotë që mallrat e prodhuara nga Kosovarët jashtë Kosovës nuk do të llogariten si pjesë e PBB-së.

Nëse një kompani e huaj prodhon dhe shet mallra ose shërbime në Kosovë, ajo llogaritet në PBB të Kosovës.

¹ <https://study.com>

1.1.Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është që ti jep lexuesit një pasqyrim të qartë dhe të detajuar rreth Prodhimit të brendshëm Bruto në përgjithësi dhe Prodhimit të brendshëm bruto të Kosovës në veçanti, mes tjerash ka për qëllim ti kuptojmë pyetjet si:

- Cka është Produkti i brendshëm Bruto (PBB)?
- Si përlllogaritet Produkti i brendshëm Bruto (PBB)?
- Cili është dallimi mes Produkti i brendshëm Bruto reale dhe nominale?
- Cka tregon Produkti i brendshëm Bruto për kokë banori?
- Sa është Produkti i brendshëm Bruto e Kosovës ?
- Rritja e Produkti i brendshëm Bruto së Kosovës 2008-2017?
- Sa ndikojnë shpenzimet qeveritare në Bruto produktin vendor?
- Si qëndron Kosova në raport me shtetet e Europes sa i përket PBB-së?
- Cfarë ndikimi ka pandemia Covid-19 në Bruto prodhimin e brendshëm?

1.2. Metodologjia e punës

Ky punim është punuar me të dhëna nga literatura të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ku si literaturë bazë është përdorur libri Hyrje në Ekonomi nga autorët Ahmet Maqallari, Sulo Haderi, Dhori Kule dhe Stefan Quriqi ndërsa janë përdorur edhe të dhëna nga librat e autorëve ndërkombëtar, Agjensioni i Statistikave dhe Ministria e Financave të Kosovës, si dhe nga të dhënat dytësore (sekondare) nga shfletimi i faqeve elektronike që janë në lidhje të ngushtë me fushën e Makroekonomisë.

2. Bruto prodhimi i brendshëm

Një Ekonomi është një zonë ku bëhet prodhimi, shpërndarja dhe tregtia, si dhe konsumi i mallrave dhe shërbimeve. Ekonomia në kuptim më të gjerë mund të përkufizohet edhe si një fushë sociale që përbën praktika, ligjërime dhe shprehje materiale të cilat lidhen me prodhimin, përdorimin si dhe administrimin e burimeve²

Prodhimi i brendshëm bruto i një vendi është një masë e madhësisë së ekonomisë së saj.

Produkti i Brendshëm Bruto (*shkurt: „PBB”*) (Anglisht -*Gross domestic product*, „GDP”) është një tregues i rëndësishëm ekonomik i cili paraqet vlerën e përgjithshme me çmimet e tregut të të mirave materjale dhe shërbimeve të prodhuara brenda për brenda një shteti gjatë një periudhe të caktuar (zakonisht një vit).

Produktin e brendshëm Bruto duhet ta dallojmë dhe mos të ngatërrojmë me prodhimin kombëtar bruto (shkurt: „PKB”), i cili shpreh vlerën totale me çmimet e tregut të të mirave të përgjithshme materiale dhe shërbimeve të prodhuara nga burime të punës dhe pronës së banorëve të një vendi (shteti) brenda apo jashtë atij shteti në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit).

² James, Paul; with Magee, Liam; Scerri, Andy; Steger, Manfred B. (2015). *Urban Sustainability in Theory and Practice: Circles of Sustainability*. London: Routledge. fq. 53.

Produkti i brendshëm bruto është treguesi kryesor Makroekonomikë për matjen e rritjes ekonomike të një vendi. Produkti i brendshëm bruto është dy lloje : Reale dhe Nominale.

Produkti i brendshëm real përfshin të gjitha mallrat dhe shërbimet përfundimtare gjatë një periudhe kohore të matura me çmime të pandryshueshme (konstante) ,ndërsa Produkti i brendshëm bruto përfshin të gjitha mallrat dhe shërbimet përfundimtare gjatë një periudhe kohore të matura me çmime korrente.³

Produkti i brendshëm përfaqëson vlerën e të gjitha shërbimeve dhe produkteve përfundimtare të prodhuara në një ekonomi për një periudhë të caktuar kohore. Ai përfshin vlerën e të mirave të prodhuara, si p.sh. shtëpitë, kompakt disqet, dhe vlerën e shërbimeve, si p.sh. udhëtimet me tren dhe leksionet e gjuhës angleze. Produkti i secilës prej tyre vlerësohet me çmimet e tij të tregut dhe vlerat mbledhen bashkë për të dhënë PBB.

Produkti i Përgjithshëm është njëri nga konceptet kryesore makroekonomike.

2.1 Përlllogaritja e Prodhimit të brendshëm Bruto

Përlllogaritja e produktit të brendshëm të një vendi përballet me problemin e agregimit, që nënkupton përfshirjen e produkteve të të gjitha ndermarrjeve në një tregues të vetëm.

Produkti i brendshëm ka tri metoda të përlllogaritjes që në parim duhet të jepin të njëjtin rezultat.

Ato metoda janë:

- Përlllogaritja sipas prodhimit,
- Përlllogaritja sipas te ardhurave, dhe
- Përlllogaritja sipas shpenzimeve.

³ Lequiller, François; Derek Blades (2006). *Understanding National Accounts*. OECD. p. 18. ISBN 978-92-64-02566-0.

2.2.Prodhimi i brendshëm bruto nominal dhe real

Produkti i brendshem bruto (PBB) përfaqëson vlerën e gjithë të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në ekonomi në një periudhë të dhënë kohore (tremujor ose vjetor).⁴

Bruto Prodhimi i Brendshëm Nominal bën matjen e vlerës së produkteve të përgjithshme për një periudhë të caktuar kohore , me çmimin e periudhës në të cilën prodhohen produktet (dmth. Çmimet e tanishme).

Bruto Prodhimi i Brendshëm Real bën matjen e produkteve të përgjithshme të prodhuara në ekonominë e një vendi për një periudhë të caktuar kohore, duke marr çmimet e një viti bazë (që mund të jetë viti paraprak ose një vit tjetër i caktuar si vit bazë).

Për shembull : Po supozojmë që në vitin 2019 ekonomia e një vendi specifik prodhon 1 Miliard \$ të mira dhe shërbime të vlerësuara me çmimet e vitit 2019. Në vitin 2020 ekonomia e këtij vendi prodhon 1.1 Miliard \$ të mira dhe shërbime të vlerësuara me çmimet e vitit 2020. Të njëjtat të mira dhe shërbime janë vlerësuar me 1.05 Miliard \$ me çmimet e vitit 2019.

Atëherë llogaritjet e rritjeve janë:

Viti 2019 Prodhimi i brendshëm bruto nominale=1 Miliard \$

Viti 2020 Prodhimi I brendshëm bruto nominale=1.1 Miliard \$, PBB reale=1.05 Miliard \$

Rritja e PBB nominale= $\frac{\text{PBB nominale, viti 2020}}{\text{PBB nominale, viti 2019}}=1.10/1=10\%$

Rritja e PBB reale= $\frac{\text{PBB reale, viti 2020}}{\text{PBB reale, viti 2019}}=1.05/1=5\%$ ⁵

⁴ Rudiger Dornbusch, Stanley Fisher "Macroeconomics" pg 26.

⁵ <http://www.instat.gov.al>

2.3 Dallimi midis “rritjes reale të PBB” dhe “rritjes nominal të PBB”

Prodhimi i brendshëm Bruto është bazë e aktivitetit ekonomik, Duhet bërë tre dallime të rëndësishme:

- ❖ PBB nominal kundrejt PBB real,
- ❖ Nivelet e PBB, nominal ose real kundrejt rritjes së PBB
- ❖ PBB kundrejt PBB për frymë

-PBB nominal mat produktin e të mirave dhe shërbimeve të prodhuara në ekonomi gjatë një periudhe të dhënë duke përdorur çmimet e kësaj periudhe. PBB real mat vlerën e prodhimit duke përdorur çmimet e një viti të dhënë. PBB real mat produktin total të prodhuar në një periudhë me çmimet e një viti bazë.⁶

Për PBB të dyja termat nënkuptojnë të njëjtën gjë, që është ajo pjesë e ndryshimit në PBB-në nominale që nuk shkaktohet nga rritja e çmimeve, por nga rritja në sasi ose cilësi e të mirave dhe shërbimeve të prodhuara. “Rritja në volum” është një term zakonisht i rezervuar për agregatë të lidhur me volumin e prodhimit, për të cilën sasia dhe cilësia fizike mund të maten dhe observohen në mënyrë direkte, së paku në parim, dhe që konsiston zakonisht në vlerën e PBB-së së matur duke shumëzuar sasinë e prodhuar në vitin korent me çmimet e vitit bazë.

“Rritja reale” është një term më i gjerë, gjithashtu i përdorur për agregatë të lidhur me të ardhurat, të cilët nuk lidhen direkt me një volum të vëzhgueshëm. Kjo metodë e dytë, e njohur gjerësisht me termin “deflatim”, konsiston në pjesëtimin e vlerave të vrojuara të PBB-së me indeksat e çmimeve të vitit bazë. Indeksat e çmimeve ndërtohen duke vlerësuar çmimet e vitit korent të kontribuesve kryesor në ekonomi, me çmimet e tyre në vitin .

⁶ Rudiger Dornbusch, Stanley Fisher “Macroeconomics” pg 26.

2.4. Produkti i brendshëm Bruto për frymë (kokë banori)

Produkti i brendshëm Bruto për kokë banori është një masë e prodhimit ekonomik të një vendi që llogarit në raport me numrin e njerëzve. Ajo ju tregon se sa i begatë është një shtet për qytetaret e vet.

Prodhimi i brendshëm për kokë banori shpreh raportin mes PBB totale në raport me numrin e popullsisë së atij vendi.

Formula për përlogaritjen e PBB-së për kokë banori shprehet : $PBB / \text{Popullsia}$

Bota në vitin 2018 kishte PBB nominale totale në vlerë 84.7 Trilion\$, dhe PBB mesatare për kokë banori 11.355 \$.⁷

Shtetet që kanë PBB nominale më të lartë për kokë banori janë: Luksemburgu me 114.234 \$ pastaj Zvicra me 82.950\$ ndersa vendet me PBB më të ultë për kokë banori janë: Sudani Jugor 303\$, Burundi 307 \$.⁸

3. Efektet ekonomike të Prodhimit të brendshëm Bruto

Ritmi i rritjes së ekonomisë përfaqëson normën me të cilën rritet PBB real.

Kush shkakton rritjen e PBB- real gjatë kohës?

-Arsyeja e parë e ndryshimit të PBB real është se ndryshon sasia disponimit të burimeve në ekonomi. Burimet ndahen në Kapital dhe Punë. Forca punëtore përbëhet nga njerëzit që punojnë ose kërkojnë punë, rritet gjatë kohës gjatë kohës duke siguruar një burim të rritjes së produktit. Stoku i kapitalit që përbëhet nga ndërtesat dhe makinat gjithashtu rritet gjatë kohës duke siguruar një tjetër burim të rritjes së prodhimit. Rritja e disponibilitetit të faktorëve të prodhimit kapitalit dhe punës së përdorur për prodhimin e të mirave dhe shërbimeve përfaqësojnë një nga arsyet e rritjes së PBB-së real.

⁷ "GDP (current US\$)". *World Development Indicators*. World Bank. Retrieved 4 May 2019.

⁸ "[World Economic Outlook Database](#)". International Monetary Fund. 10 April 2019

-Arsyeja e dytë e ndryshimit të PBB-së real është se efienca me të cilin përdoren faktorët e prodhimit mund të ndryshojë. Përmirësimet e eficiencës quhen rritje të rendimentit.⁹

4. Prodhimi i brendshëm bruto dhe mirëqenia ekonomike

Produkti i brendshëm Bruto është masa më e mirë e vetme për të matur mirëqenien ekonomike të një shoqërie, mirëpo prapë se prapë në Produkti i brendshëm Bruto nuk përfshihen edhe disa elemente të tjera të mirëqenies ekonomike.

Disa gjëra që kontribuojnë në mirëqenien e që nuk janë të përfshira në Produkti i brendshëm Bruto:

-Vlera e kohës së lirë.

-Vlera e një mjedisi të pastër.

-Vlera e pothuajse të gjithë aktiviteteve që zhvillohen jashtë tregjeve, të tilla si vlera e kohës që kalojnë prindërit me fëmijët e tyre, vlerës së punës vullnetare, aktiviteteve rikrijuese etj.

5. Rritja e Prodhimi të brendshëm të Kosovës 2008-2017

Nga ajo që mësuam më herët kuptuam që Bruto prodhimi i brendshëm përfshin të gjitha produktet që janë prodhuar brenda kufijve të një shteti brenda një periudhe të caktuar kohore saktësisht brenda një viti. Në rastin tonë konkret që kemi marr Prodhimin e brendshëm të Republikës së Kosovës për vitet 2008-2017 kemi vërejtur një rritje të lehtë në vitin 2016 Kosova kishte PBB në vlerë 6.07 miliard euro, ndërsa në vitin 2017 kishte 6.28 miliard euro me një rritje 3.5%, në vit, pastaj në vitin 2018 kishte PBB 6.53 miliard euro me rritje 3.92% që në përqindje është më e larta me shtetet e rajonit. Mesatarja e rritjes së PBB-së së Kosovës është 4% në vit.¹⁰

Në Kosovë shumica e bruto prodhimit shkon për konsum final të ekonomive shtëpiake perafërsisht rreth 40% e prodhimit të brendshëm bruto.

⁹ Rudiger Dornbusch, Stanley Fisher "Macroeconomics" pg 28

¹⁰ "[World Economic Outlook Database](#)". International Monetary Fund. 10 April 2019

Në tabelën e mëposhtme do të shohim Bruto Prodhimin e përgjithshëm të Kosovës në vitet 2008-2017 si dhe indikatorët e Bruto prodhimit të brendshëm.

Shohim që kemi rritje të lehtë pozitive konstante tek dy indikatorët e GDP-së Konsumi dhe Shpenzimet qeveritare, ndërsa tek Investimet dhe Neto Eksporti shohim që ka edhe lëvizje negative ku vlen të ceket që Investimet në vitin 2011- 2012 kanë rënë nga 1.63 Miliard Euro në 1.46 Miliard euro, ndërsa tek Neto Eksporti vlen të ceket vitet 2015-2016 ku balanca eksport-import ka rënë negativisht nga -1.65 Miliard euro në -1.73 miliard euro.

GDP dhe faktorët (*Milion)					
Vitet	GDP	Konsumi	Shpenzimet	Investimet	Eksporti Neto
2008	3882.7	3512.4	659.8	1208.7	-1498.2
2009	4069.6	3553.5	668.1	1267.4	-1419.4
2010	4401.9	3794.2	722.3	1450.6	-1565.2
2011	4814.6	4173.4	802.1	1632.4	-1793.3
2012	5058.7	4478.3	842.1	1465.1	-1726.8
2013	5326.6	4675.4	863.9	1470.9	-1683.6
2014	5567.6	4821	910.4	1434.9	-1598.7
2015	5807.5	4964.6	893.9	1601.3	-1652.3
2016	6070.1	5291.9	853.9	1650.1	-1725.8
2017	6413.9	5391.7	862.6	1819.7	-1660.1

Figura 1. Bruto Prodhimi i Brendshëm I Kosovës me çmim aktual dhe faktorët¹¹

¹¹ <http://ask.rks-gov.net/media/4722/buletini-tremujor-tm1-2019.pdf>

5.1 Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike

Bazuar në hulumtimin e literaturës, shpenzimet qeveritare luajnë një rol të rëndësishëm në rritje ekonomike.

Hulumtimet e autorëve të ndryshëm theksojnë rëndësinë e shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike.

“Qeveria ndikon drejtpërdrejt mbi nivelin ekuilibër të të ardhurave në dy mënyra të veçanta. Së pari, blerjet qeveritare të të mirave dhe shërbimeve, G , janë një komponent i kërkesës agregate. Së dyti, taksat dhe transferat ndikojnë në lidhjen midis produktit të të ardhurave, Y , dhe të ardhurave të disponushme, YD , - të ardhurat në dispozicion që i shkojnë familjeve për konsum ose kursim.” (Rudiger Dornbusch , Stanley Fisher, Macroeconomics, 2000)

“Shpenzimet qeveritare të blerjes kanë një efekt pozitiv me formimin e kapitalit privat, dhe kjo përfaqësohet nga ndikimi pozitiv në rritjen ekonomike afatgjatë. Sidoqoftë, nuk mund të vërtetohet se fondet themelore të ndërtimit të qeverisë kontribuojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike afatgjatë. Sidoqoftë, u zbulua se shpenzimet e të ardhurave jo-tatimore kanë një ndikim të fortë pozitiv në rritjen ekonomike afatshkurtër, megjithëse jo në mënyrë të konsiderueshme për rritjen e PBB-së afatgjatë. Prandaj, ndikimi i kësaj pjese të shpenzimeve qeveritare në rritjen e PBB-së nuk duhet të injorohet” (Yaliu Pan)¹²

¹² Informatics and Management Science VI (pp. 303)

5.1 Trendi i shpenzimeve qeveritare gjatë periudhës 2008-2017

Nga analiza e raporteve të ASK-së , vërejmë se trendi i shpenzimeve qeveritare shënon një rritje nga viti 2009 deri në vitin 2015, pastaj pëson një rënie të lehtë në vitet 2015-16.

Rritja më e madhe e shpenzimeve qeveritare vërehet prej 689.8 milion në vitin 2008, në 910.4 milion në vitin 2015.




Figura 2. Shpenzimet qeveritare dhe PBB-ja¹³

5.2 Shpenzimet qeveritare, GDP-ja dhe konsumi

GDP dhe faktorët (*Milion)			
Vitet	GDP	Konsumi	Shpenzimet
2008	3882.7	3512.4	659.8
2009	4069.6	3553.5	668.1
2010	4401.9	3794.2	722.3
2011	4814.6	4173.4	802.1
2012	5058.7	4478.3	842.1
2013	5326.6	4675.4	863.9
2014	5567.6	4821	910.4
2015	5807.5	4964.6	893.9
2016	6070.1	5291.9	853.9
2017	6413.9	5391.7	862.6

Figura 3. Shpenzimet qeveritare, GDP-ja dhe konsumi¹⁴

¹³ Agjensioni statistikor I Kosovës, 2017

¹⁴ <http://ask.rks-gov.net/media/4722/buletini-tremujor-tm1-2019.pdf>

Nga rezultatet e nxjerra vërejmë se shpenzimet qeveritare kanë lidhje pozitive me GDP.

Kjo nënkupton se nëse shpenzimet qeveritare , rritet me 1%, GDP rritet për 0.88%, pra ekziston një lidhje pozitive në mes të shpenzimeve qeveritare dhe GDP-së.

Me rritjen e konsumit, për 1%, GDP rritet për 0.99%, pra ekziston lidhje pozitive edhe në mes të konsumit dhe GDP-së.

Lidhja në mes shpenzimeve qeveritare dhe konsumit është pozitive, me rritjen e shpenzimeve qeveritare 1% , konsumi rritet 0.89%.


6. Krahasimi mes Produktit të brendshëm Bruto dhe Produktit kombëtar Bruto të Kosovës

Nëse bëjmë një krahasim mes Kosovës dhe shteteve të rajonit atëherë shohim që Kosova ka Bruto Prodhimin më të ulët pas Malit të Zi.

Gjatë viteve 2016-2016 është vazhdu tempo e njejtë e rritjes ekonomike të Kosovës ku prin në Ballkan për rritjen më të lartë ekonomike me mesatare rreth 4% duke u pasuar nga Mali I Zi me 3.9%, pastaj Shqipëria me 3.7%, Bosnja dhe Hercegovina me 3%, Serbia me 1.9% etj.

Padyshim që Kosova më këtë normë të rritjes ekonomike është ndër të parat edhe në Europë. Mirëpo rrethanat politike dhe ekonomike ndikojnë për ngecje në shumë sfera të zhvillimit të mëtutjeshëm ku jo rrallë here shohim bllokada në organizata të ndryshme ndërkombtare që kanë rëndësi dhe ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Situata e ngjajshme me Kosovën është edhe në shtetet e tjera të rajonit të cilat për nga zhvillimi ekonomik janë bukur larg nga shtetet e tjera të Europës që kanë standard të lartë të jetesës.



15

Figura 4. PBB-ja nominal dhe real për kokë banori në vendet rajonit.

Nga këto që shohim vërejmë që dy shtetet e rajonit që tashmë janë edhe antare të Unionit europian Sllovenia dhe Kroacia kanë një standard shumë më të mirë jetësor se sa shtetet e tjera.

Ndërsa sa i përket Bruto prodhimit për kokë banori Kosova është e fundit në rajon me vetëm 3670 euro për kokë banori.

Nëse përjashtojmë ato dy shtete dhe analizojmë shtetet tjera të rajonit shohim që Mali I Zi qëndron më së miri për Bruto prodhimin për kokë banori.

¹⁵ Central European Financial Observer




Figura 5. Krahasimi i PBB-së së Kosovës me vendet e rajonit.

7. Ndikimi i pandemisë së koronavirusit në ekonominë globale

Ndërsa nuk ka asnjë mënyrë për të treguar saktësisht se cili do të jetë dëmi ekonomik nga pandemia globale e koronavirusit COVID-19, ekziston një marrëveshje e përhapur midis ekonomistëve që do të ketë ndikime të rënda negative në ekonominë globale. Vlerësimet e hershme predikonin se, nëse virusi shndërrohet në një pandemi globale, shumica e ekonomive kryesore do të humbasin të paktën 2.9 përqind të prodhimit të tyre të brendshëm bruto (PBB) gjatë vitit 2020. Ky parashikim tashmë ishte ripërtërirë në një humbje të PBB -së prej 4.5 përqind. Për ta vënë këtë numër në perspektivë, PBB -ja globale u vlerësua në rreth 87.55 trilionë dollarë amerikanë në vitin 2019 - që do të thotë se një rënie prej 4.5 përqind në rritjen ekonomike rezulton në gati 3.94 trilionë dollarë të prodhimit të humbur ekonomik.

7.1. Ndikimi në tregjet globale të aksioneve

Tregjet globale të aksioneve gjithashtu kanë pësuar rënie dramatike për shkak të shpërthimit të koronavirusit, megjithëse ata ishin në gjendje të shëroheshin nga humbjet mjaft shpejt. Doë Jones raportoi humbjen e tij më të madhe në ditë të vetme prej gati 3,000 pikësh në 16 Mars 2020-duke tejkaluar rekordin e tij të mëparshëm prej 2,300 pikësh që ishte vendosur vetëm katër ditë më parë.

7.2.Industritë e prekura

Dëmi ekonomik i shkaktuar nga pandemia COVID-19 nxitet kryesisht nga rënia e kërkesës, që do të thotë se ka më pak konsumatorë të gatshëm të blejnë mallra dhe shërbime të disponueshme në ekonominë globale. Kjo dinamikë mund të shihet qartë në industritë e prekura shumë si udhëtimi dhe turizmi. Për të ngadalësuar përhapjen e virusit, vendet kanë vendosur kufizime në udhëtime dhe shumë njerëz nuk mund të blinin fluturime për pushime ose udhëtime pune. Kjo ulje e kërkesës së konsumatorit ishte arsyeja pse linjat ajrore humbën të ardhurat e planifikuara dhe si rezultat u desh të shkurtonin shpenzimet e tyre duke zvogëluar numrin e fluturimeve që ata operonin. Pa ndihmën e qeverisë, përfundimisht linjat ajrore do të kenë nevojë të heqin dorë nga punët për të ulur më shumë kosto.

E njëjta dinamikë vlen edhe për industritë e tjera, për shembull me rënien e kërkesës për naftë dhe makina të reja pasi udhëtimet ditore, ngjarjet shoqërore dhe festat nuk janë më të mundshme. Ndërsa kompanitë fillojnë të zvogëlojnë punësimin për të kompensuar të ardhurat e humbura, shqetësimi është se kjo do të krijojë një spirale ekonomike në rënie kur këta punëtorë të sapo papunësuar nuk do të kenë mundësi të blejnë më shumë mallra dhe shërbime si më parë. Kjo dinamikë i bën ekonomistët të mendojnë nëse pandemia COVID-19 mund të çojë në një recesion global në shkallën e Depresionit të Madh.¹⁶

7.3.Mbështetja e qeverisë

Pavarësisht rrezikut të qartë në të cilin ndodhet ekonomia globale, ka edhe arsye për të shpresuar se ky skenar i rastit më të keq mund të shmanget. Qeveritë kanë mësuar nga krizat e mëparshme se efektet e një recesioni të nxitur nga kërkesa mund të kundërshtohen me shpenzimet e qeverisë. Rrjedhimisht, shumë qeveri po rrisin sigurimin e tyre të mirëqenies monetare për qytetarët, dhe duke siguruar që bizneset të kenë akses në fondet e nevojshme për të mbajtur stafin e tyre të punësuar gjatë gjithë pandemisë. Për më tepër, natyra specifike e kësaj krize do të thotë që disa sektorë mund të përfitojnë prej saj. Tregtia elektronike, shitja me pakicë e ushqimit dhe industria e kujdesit shëndetësor sigurojnë të paktën një rritje ekonomike për të kompensuar dëmin. Gjithashtu, mund të vërehet një lëvizje e shkaktuar nga kriza në aktivitetet online (puna nga

¹⁶ M. Szmigiera, 15 shtator 2021

shtëpia, blerja e mallrave në internet, kontaktimi me familjen, etj.). Ai jep një mundësi për ofruesit e zgjidhjeve të TI -së që të rrisin pjesët e tyre të tregut.

7.4.Kthimi në normalitet

Së fundi, ekziston fakti që kriza mund të ketë një datë të qartë përfundimi kur të gjitha kufizimet mund të hiqen-kjo duket të jetë e mundur kur shumica e popullsisë globale të vaksinohen kundër COVID-19. Mund të mundësojë që ekonomia globale të përjetojë një rikthim të mprehtë sapo të mbarojë pandemia. Ende ka shumë variabla që mund të ndikojnë në një rimëkëmbje të tillë ekonomike-për shembull, një furnizim i reduktuar i mallrave dhe shërbimeve për të përmbushur kërkesën më të ulët mund të krijojë mungesa afatmesme dhe rritje të çmimeve-por ka disa arsye për të menduar se, me përzierjen e duhur me përgjigjet dhe fatin e duhur të qeverisë, disa nga parashikimet më apokaliptike mund të mos realizohen.¹⁷

Pandemia e koronavirusit ka prekur pothuajse çdo vend në botë.

Nga grafiku i mëposhtëm shohim dallimin në disa shtete të botës të përqindjes (%) së papunësisë para dhe në pandemi specifikisht në vitin 2019 dhe 2020.

Ngecja e ekonomive botërore me rritjen e papunësisë

Ndryshimi i nivelit të papunësisë gjatë një viti, krahasimi mes viteve 2019-2020

Ngecja e ekonomive botërore me rritjen e papunësisë

Ndryshimi i nivelit të papunësisë gjatë një viti, krahasimi mes viteve 2019-2020


Ngecja e ekonomive botërore me rritjen e papunësisë

Ndryshimi i nivelit të papunësisë gjatë një viti, krahasimi mes viteve 2019-2020

¹⁷ M. Szmigiera, 15 shtator 2021

Ngecja e ekonomive botërore me rritjen e papunësisë

Ndryshimi i nivelit të papunësisë gjatë një viti, krahasimi mes viteve 2019-2020



Source: International Monetary Fund

BBC


18

Figura 6. Ndikimi i Covid-19 në papunësi.

Në SHBA, përqindja (%) e papunësisë ka arritur në total vjetor 8.9% sipas FMN-së. Po ashtu shohim edhe rritje të papunësisë edhe në vendet tjera si Brazil, Itali, Kanada, Francë, Britani të Madhe, etj.

¹⁸ Fondi monetar nderkombtar 24 janar 2021.

Recesioni i Prodhimit të brendshëm Bruto nga Covid-19



Source: International Monetary Fund

BBC

Figura 7. Recesioni i Prodhimit të brendshëm Bruto nga Covid-19.

E vetmja ekonomi e madhe që u rrit në vitin 2020 ishte Kina. Ajo regjistroi një rritje prej 2.3%.

Sidoqoftë, FMN -ja parashikon rritje globale prej 5.2%.


Kjo do të nxitet kryesisht nga vende të tilla si India dhe Kina, të parashikuara të rriten përkatësisht me 8.8% dhe 8.2%.

Rimëkëmbja në ekonomitë e mëdha, të varura nga shërbimet, që janë goditur rëndë nga shpërthimi, të tilla si Mbretëria e Bashkuar ose Italia, pritet të jetë i ngadalshëm.

7.5. Aksionet globale në fluks

Në figurën e mëposhtme shohim edhe levizjet e aksioneve në tregje, ku vlen të ceket FTSE e cila pësoi rënie prej 14.3% në vitin 2020 që shfaq performancën më të keqe qysh nga viti 2008, që ishte ndër krizat më të mëdha të tregjeve financiare që njih historia e ekonomisë.

Ndikimi i Covid-19 në tregjet financiare



Source: Bloomberg, 24 January 2021, 00:01 GMT

BBC

Figura 8. Impakti i Covid-19 në tregjet financiare.

Përfundimet

Nga të gjitha ato që përmendëm më lartë kuptuam që Bruto Prodhimi i Brendshëm është element kyç dhe kryesor makroekonomik për të kuptuar shumëçka rreth ekonomisë së atij vendi.

Kosova llogaritet ndër vendet më të varfëra në Europë me një GDP të ulët. Gjithashtu edhe GDP për kokë banori është tejet e ulët.

Nëse e shiqojmë ndër vite GDP-ja në Kosovë tregon trend rritës. Mirëpo një rritje e tillë është e ulët dhe vështirë se arrihet që të reduktohet hendeku mes Kosovës dhe vendeve të zhvilluara.

Bruto Prodhimi i Brendshëm ka rëndësi të veçantë dhe shumë të rëndësishme edhe për ndërmarrjet ekonomike për shkak se Bruto Produkti i Brendshëm siguron një indikator të drejtpërdrejtë të shëndetit dhe rritjes së ekonomisë, bizneset mund të përdorin Bruto Prodhimi i Brendshëm si një udhëzues për strategjinë e tyre afatgjata të biznesit. Investitorët gjithashtu e shohin Bruto Prodhimi i Brendshëm pasi që ajo siguron një kuadër për vendimmarrjen e investimeve.

Literatura

1. Ahmet Maqallari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Quriqi -Hyrje në Ekonomi
2. Rudiger Dornbuch, Stanley Fisher- Macroeconomics (1994)
3. Banka Botërore , Washington D.C. SHBA (2018)
4. Fondi Monetar Ndërkombëtar , Washington D.c. SHBA (2018)
5. James, Paul -Urban Sustainability in Theory and Practice: Circles of Sustainability. London (2015)
6. Lequiller, François; Derek Blades - *Understanding National Accounts*.(2006)
7. Du, Ęenjiang “Informatics and Management Science VI”(2012)
8. Agjensioni Statestikor I Kosovës , Prishtinë, Kosovë.
9. Agjensioni Statestikor I Shqipërisë , Tiranë , Shqipëri.
10. Investopedia.com
11. Study.com
12. Central European Financial Observer (2016)